

VENDIM
Nr. 74, datë 22.12.2015

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese			
Vladimir Kristo	anëtar i	“		“
Sokol Berberi	anëtar i	“		“
Vitore Tusha	anëtare e		“	“
Altina Xhoxhaj	anëtare e		“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“		“
Besnik Imeraj	anëtar i	“		“
Fatos Lulo	anëtar i		“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“		“

me sekretare Edmira Babaj, në datën 14.4.2015 mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 20 Akti, që i përket:

KËRKUESE: Shoqëria “Iliria” s.r.l.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, Avokatura e Shtetit

OBJEKTI: Shfuqizimi si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i vendimeve nr. 35, datë 31.3.2009 të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 00-2013-2018, datë 4.10.2013 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi).

BAZA LIGJORE: Neni 42 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 6/1 dhe 13 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (KEDNJ); neni 27 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Fatmir Hoxha, mori në shqyrtim pretendimet e paraqitura me shkrim nga kërkuesja, shoqëria “Iliria” s.r.l., e cila ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjekteve të interesuara, Këshillit të Ministrave dhe Avokaturës së Shtetit, të cilat kanë kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Midis kërkueses, shoqërisë “Iliria” s.r.l., dhe qeverisë shqiptare, përfaqësuar nga Ministria e Ekonomisë dhe ish-Ndërmarrja Komunale e Plazhit Durrës, në datën 26.3.1991 është lidhur një marrëveshje për krijimin e ndërmarrjes së përbashkët italo-shqiptare me qëllim zhvillimin e turizmit.

2. Marrëveshja është ratifikuar me vendimin nr. 119, datë 28.3.1991 të Këshillit të Ministrave. Për shkak të mosmarrëveshjeve që kanë lindur për mënyrën dhe fondet e investimit, kërkuesja i është drejtuar Gjykatës së Arbitrazhit Ndërkombëtar.

3. Me vendimin e datës 13.7.1993, Gjykata e Arbitrazhit Ndërkombëtar ka detyruar qeverinë shqiptare t’i paguajë kërkueses shumën prej 48.239.000.000 liretash italiane me kamatë vjetore 13% të shumës.

4. Me shkresën nr. prot. 2247, datë 25.5.1995, Ministria e Financave i ka komunikuar kërkueses negocimin e shumës me bankat private, duke e siguruar se kur të nënshkruhet marrëveshja, do të

fillojë të bëhet edhe pagesa.

5. Pas dështimit të procedurave të pajtimit, kërkesja ka filluar procesin gjyqësor për njohjen e vendimit të Gjykatës së Arbitrazhit Ndërkombëtar. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 6, datë 2.4.1998, ka njohur vendimin e datës 13.7.1993 të Gjykatës së Arbitrazhit Ndërkombëtar. Vendimi është plotësuar për pjesën e kamatave ligjore me vendimin nr. 73, datë 5.5.2000 të po kësaj gjykate.

6. Me vendimin nr. 8, datë 10.4.1998, Gjykata e Apelit Tiranë, me kërkesën e kërkuësës, ka vendosur lëshimin e urdhrat të ekzekutimit të vendimit gjyqësor nr. 6, datë 2.4.1998 të Gjykatës së Apelit Tiranë.

7. Pas dhënies së vendimeve të lartpërmendura, kërkesja, me shkresën nr. prot. 109/1, datë 9.6.1998, i është drejtuar qeverisë shqiptare me dokumentacionin përkatës për ekzekutimin e tyre. Këshilli i Ministrave, nga ana e tij, me shkresën nr. prot. 1/53, datë 3.8.1998, ia ka përcjellë dokumentet Ministrisë së Financave.

8. Me shkresën nr. prot. 354/200, datë 20.9.1998, kërkesja i është drejtuar përsëri Këshillit të Ministrave dhe Ministrisë së Financave për kryerjen e pagesave, duke i bashkëngjitur përsëri gjithë dokumentacionin përkatës dhe të gjitha vendimet për ekzekutim. Prej kësaj shkrese rezulton se kërkesja i është drejtuar edhe Zyrës së Përmbarrimit Tiranë në datën 31.8.1998.

9. Me shkresën nr. prot. 251/gj, datë 30.4.2002, Zyra e Përmbarrimit Tiranë i është drejtuar Bankës së Kursimeve të Shqipërisë. Prej këtij dokumenti rezulton se ka filluar procedura e ekzekutimit të vendimit nr. 6, datë 2.4.1998 të Gjykatës së Apelit Tiranë. Po ashtu, me shkresën nr. prot. 251/gj, datë 20.5.2002, Zyra e Përmbarrimit i është drejtuar Avokaturës së Shtetit pranë Këshillit të Ministrave, si dhe Drejtorisë së Buxhetit pranë Ministrisë së Financave.

10. Në datën 18.12.2003 Këshilli i Ministrave i është drejtuar Gjykatës së Apelit Tiranë me kërkesë për rivendosje në afat të ankimit ndaj vendimeve nr. 6, datë 2.4.1998 dhe nr. 73, datë 5.5.2000 të Gjykatës së Apelit Tiranë, me arsyetimin se procesi gjyqësor është zhvilluar në mungesë të tij dhe se vendimet nuk i janë komunikuar.

11. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 179, datë 26.12.2003, ka vendosur pranimin e kërkesës, duke rivendosur në afat të drejtën e ankimit të subjektit të interesuar. Ky proces është zhvilluar në mungesë të kërkuësës, shoqërisë "Iliria" s.r.l.

12. Me vendimin nr. 222, datë 10.2.2005, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur prishjen e vendimeve nr. 6, datë 2.4.1998 dhe nr. 73, datë 5.5.2000 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe kthimin e çështjes për gjykim në po atë gjykatë, por me tjetër trup gjykues.

13. Gjykata e Apelit Tiranë, në rigjykimin e çështjes, me vendimin nr. 21, datë 14.2.2006, ka vendosur pushimin e gjykimit të çështjes për shkak të moslegjitimitit të përfaqësuesit të kërkuësës, pasi kërkesa për njohjen dhe dhënien fuqi të vendimit të huaj ishte nënshkruar në kapërcim të tagrave të deleguara nga administratori i shoqërisë "Iliria" s.r.l.

14. Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 1067, datë 26.9.2007, ka vendosur prishjen e vendimit nr. 21, datë 14.2.2006 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Apelit Tiranë, me tjetër trup gjykues. Gjykata e Lartë ka arsyetuar se për shkak të natyrës së çështjes, Gjykata e Apelit e shqyrton çështjen si gjykatë e shkallës së parë. Për këtë arsye ajo (Gjykata e Apelit) duhet t'i jepte kërkuësës kohën e nevojshme për plotësimin e të metave lidhur me aktin e përfaqësimit. Gjykata e Lartë, gjithashtu, ka orientuar Gjykatën e Apelit Tiranë se duhet të respektonte parimin e kontradiktoritetit dhe të dëgjonte shpjegimet e palës kërkuëse.

15. Gjatë kohës që çështja ishte për rishqyrtim në Gjykatën e Apelit Tiranë, kërkesja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese duke kërkuar konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si rrjedhojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë.

16. Gjykata Kushtetuese, me vendimin nr. 26, datë 25.3.2009 të Mbledhjes së Gjyqtarëve, ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare, duke vlerësuar se nuk ka ende një vendim të formës së prerë, pasi çështja është akoma në shqyrtim në Gjykatën e Apelit Tiranë dhe si

pasojë kërkesja nuk ka shteruar mjetet e ankimit.

17. Gjykata e Apelit Tiranë, duke zbatuar detyrat e lëna nga Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 35, datë 31.3.2009, ka vendosur rrëzimin e kërkesës së shoqërisë “Iliria” s.r.l. për njohjen dhe dhënien fuqi të vendimit të datës 13.7.1993 të Gjykatës së Arbitrazhit Ndërkombëtar, me arsyetimin se nuk pajtohet me parimet bazë të legjislacionit shqiptar dhe se nuk përmbushen kriteret e përcaktuara nga nenet 393-399 të Kodit të Procedurës Civile (KPC) për njohjen e vendimeve të gjykatave të shteteve të huaja.

18. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi), me vendimin nr. 00-2012-869, datë 12.4.2012, ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkesja, pasi nuk përmban shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 472 të KPC-së.

19. Mbi kërkesën e kërkeses për cenim të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, Gjykata Kushtetuese, me vendimin nr. 31, datë 10.7.2013 ka vendosur pranimin pjesërisht të kërkesës duke shfuqizuar vendimin nr. 00-2012-869, datë 12.4.2012 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi) dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën e Lartë.

20. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi) me vendimin nr. 00-2013-2018, datë 4.10.2013 ka vendosur përsëri mospranimin e rekursit.

II

21. **Kërkesja, shoqëria “Iliria” s.r.l.**, i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese për shfuqizimin e vendimeve nr. 35, datë 31.3.2009 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr. 00-2013-2018, datë 4.10.2013 të Kolegjit Civil i Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi) me pretendimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, duke parashtruar në mënyrë të përmbledhur:

21.1 *Është cenuar parimi i sigurisë juridike dhe i zbatimit të ligjit në kohë dhe hapësirë.* Gjykata e Apelit ka shqyrtuar kërkesën e paraqitur në vitin 1998 duke zbatuar për zgjidhje një ligj të mëvonshëm, Konventën e New York-ut të ratifikuar në vitin 2000. Parimisht, gjykata zgjidh mosmarrëveshjet në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Duke i mohuar kërkeses të ushtrojë në kohë të drejtën e saj janë cenuar parime kushtetuese si ai i sigurisë juridike dhe i zbatimit të ligjit në kohë.

21.2 *Është cenuar parimi i arsyetimit të vendimit gjyqësor.* Në rekursin e paraqitur në Gjykatën e Lartë ishin parashtruar fakte, të cilat gjejnë pasqyrim në materialet e dosjes. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë duke vendosur përsëri mospranimin e rekursit ka cenuar të drejtën e aksesit në gjykatë. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi), me vendimin nr. 00-2013-2018, datë 4.10.2013, ka cenuar parimin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, pasi është mjaftuar me arsyetimin se shkaqet e parashtruara në rekurs nuk plotësojnë kriteret e nenit 472 të KPC-së.

21.3 *Është cenuar parimi i gjykimit brenda një afati të arsyeshëm* si rrjedhojë e moszbatimit të rregullt të dispozitave ligjore në fuqi nga Gjykata e Apelit dhe Gjykata e Lartë. Pas vendimit nr. 179, datë 26.12.2003 të Gjykatës së Apelit Tiranë, me të cilin u rivendos në afat e drejta e ankimit të subjektit të interesuar, Këshillit të Ministrave, kërkesja ka marrë përgjigje vetëm pas 11 vjetësh me vendimin nr. 35, datë 31.3.2009 të Gjykatës së Apelit Tiranë.

21.4 *Është cenuar parimi i paanshmërisë* gjatë gjykimit në Gjykatën e Lartë. Rezulton se gjyqtarët A.N. dhe A.D. kanë marrë pjesë në trupin gjykues që ka gjykuar më parë të njëjtën çështje.

22. **Subjektet e interesuara, Këshilli i Ministrave dhe Avokatura e Shtetit**, paraqitën parashtrime me shkrim, duke argumentuar:

22.1 Kërkesja nuk legjitimohet në kërkesën e saj drejtuar Gjykatës Kushtetuese për shfuqizimin e vendimit nr. 35, datë 31.3.2009, pasi kërkesa është paraqitur jashtë afatit 2-vjeçar të parashikuar nga ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

22.2 Pretendimi për shfuqizimin e vendimit nr. 35, datë 31.3.2009 të Gjykatës së Apelit Tiranë

është i pabazuar, sepse çështja është *gjë e gjykuar*. Gjykata Kushtetuese, me vendimin nr. 31, datë 10.7.2013, u ka dhënë përgjigje pretendimeve se vendimi nr. 35, datë 31.3.2009 i Gjykatës së Apelit Tiranë nuk ka cenuar parimin e sigurisë juridike, të drejtën e ankimit (rekursit), si dhe të drejtën e mbrojtjes dhe parimin e kontradiktoritetit. Gjykata Kushtetuese ka vlerësuar se kërkesja nuk i ka shteruar mjetet juridike, pasi nuk i ka parashtruar këto pretendime në rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë.

22.3 Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi) duke vendosur mospranimin e rekursit nuk ka cenuar *parimin e arsytimit të vendimit gjyqësor*. Kolegji ka vlerësuar pretendimet e kërkeses, sipas fakteve të pasqyruara në dosje, dhe ka arritur në përfundimin se nuk ka shkaqe për ta kaluar çështjen në seancë. Nga leximi në tërësi i vendimit rezulton se rrjedha logjike e përdorur në vendim është e qartë dhe e kuptueshme.

22.4 Pretendimi *për cenim të parimit të gjykimit brenda një afati të arsyeshëm* është i pabazuar dhe nuk duhet të merret parasysh, pasi vendimi i Gjykatës Kushtetuese, me të cilin është vendosur dërgimi i çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë, është i datës 10.7.2013 dhe vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi), objekt gjykimi, është i datës 4.10.2013.

22.5. Pretendimi *për cenim të parimit të paanshmërisë* është i pabazuar, pasi kërkesja nuk ka sjellë asnjë argument kushtetues për qëndrimin e njëanshëm të gjyqtarit A.N.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

23. Kërkesja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) duke pretenduar cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor gjatë procesit të zhvilluar nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm. Konkretisht, kërkesja ka pretenduar se gjatë gjykimit në Gjykatën e Apelit Tiranë është cenuar parimi i sigurisë juridike, parimi i veprimit të ligjit në kohë dhe parimi i gjykimit brenda një afati të arsyeshëm. Ndërsa gjatë gjykimit në Gjykatën e Lartë, sipas saj, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi), me vendimin nr. 00-2013-2018, datë 4.10.2013, ka cenuar parimin e gjykimit nga një gjykatë e paanshme dhe parimin e arsytimit të vendimit gjyqësor.

24. Gjykata, paraprakisht, thekson se i vlerëson pretendimet e kërkeses në vështtrim të standardeve kushtetuese që imponon e drejta për një proces të rregullt ligjor dhe, konkretisht, në aspektin e detyrimit të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm për respektimin e këtyre standardeve.

A. Për pretendimin e cenimit të parimit të sigurisë juridike, të së drejtës së ankimit (rekursit), të së drejtës së mbrojtjes dhe të parimit të kontradiktoritetit, si dhe të parimit të zbatimit të ligjit në kohë

25. Kërkesja ka pretenduar se Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 35, datë 31.3.2009, ka cenuar parimin e sigurisë juridike, të drejtën e ankimit (rekursit), të drejtën e mbrojtjes dhe parimin e kontradiktoritetit, si dhe parimin e zbatimit të ligjit në kohë.

26. Gjykata konstaton se pretendimet e mësipërme kërkesja i ka paraqitur edhe më parë në kërkesën e saj drejtuar Gjykatës Kushtetuese. Me vendimin nr. 31, datë 10.7.2013, Gjykata ka vendosur pranimin pjesërisht të kërkesës, duke shfuqizuar vendimin nr. 00-2012-869, datë 12.4.2012 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi) dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën e Lartë, për shkak të mosrespektimit të standardit kushtetues të arsytimit të vendimit gjyqësor, si pasojë e mosparaqitjes në vendimin e dhomës së këshillimit të shkaqeve të parashtruara në rekurs. Kurse në lidhje me pretendimet për cenimin e parimit të sigurisë juridike, të së drejtës së ankimit (rekursit), të së drejtës së mbrojtjes dhe parimit të kontradiktoritetit, i ka dhënë përgjigje kërkeses, duke arsyetuar se lidhur me to, ajo nuk ka shteruar mjetet juridike, pasi nuk i ka parashtruar në rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë.

27. Kërkesja ka pretenduar, gjithashtu, cenimin e parimit të zbatimit të ligjit në kohë, pasi Gjykata e Apelit për zgjidhje e mosmarrëveshjes ka zbatuar një ligj të mëvonshëm, Konventën e New York-ut.

28. Gjykata konstaton se Gjykata e Apelit në rigjykim për zgjidhjen e çështjes i është referuar kontratës dhe statutit të shoqërisë, vendimeve të Këshillit të Ministrave nr. 406, datë 6.11.1991 dhe nr. 119, datë 26.4.1991, Kodit Civil të vitit 1981, ligjit nr. 3920, datë 21.11.1964, ligjit nr. 7491, datë 29.4.1991, “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, Konventës së New York-ut të datës 10.6.1958, që ka hyrë në fuqi në datën 7.6.1959, “Për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja të arbitrazhit”, ku kemi aderuar me ligjin nr. 8688, datë 9.11.2000, Konventës së Gjenevës të datës 21.5.1961, Konventës Europiane të Arbitrazhit, ku kemi aderuar me ligjin nr. 8687, datë 9.11.2000, Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe Kodin e Procedurës Civile.

29. Gjykata vëren se pretendimi për cenimin e parimit të sigurisë juridike lidhur me zbatimin e ligjit në kohë lidhet me mënyrën e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit material nga gjykatat e zakonshme, si i tillë, ky pretendim nuk hyn në juridiksionin kushtetues.

30. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se në këtë aspekt kërkuar nuk i është cenuar ndonjë prej elementeve të procesit të rregullt ligjor.

B. *Për pretendimin e cenimit të parimit të arsyetimit të vendimit gjyqësor*

31. Kërkuarja ka pretenduar se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi), me vendimin nr. 00-2013-2018, datë 4.10.2013, ka cenuar parimin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, pasi nuk ka arsyetuar shkaqet e mospranimit të rekursit.

32. Gjykata në jurisprudencën e saj, referuar natyrës së gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, ka theksuar se vetëm kur janë të pranishme pretendime që kanë të bëjnë me shkeljen e parimeve themelore të procesit gjyqësor, si dhe kur këto pretendime gjejnë pasqyrim në materialet e çështjes, atëherë vendimi i Kolegjit për mospranimin e rekursit vë në dyshim të drejtën për një proces të rregullt ligjor (*shih vendimet nr. 22, datë 6.6.2011; nr. 19, datë 19.7.2005 të Gjykatës Kushtetuese*).

33. Në nenin 475 të KPC-së sanksionohet se rekursi, ndër të tjera, duhet të përmbajë shkaqet për të cilat kërkohet prishja e vendimit, duke iu referuar normave ligjore mbi të cilat mbështetet, dhe se shqyrtimi i çështjes në kolegjet seleksionuese konsiston në një vlerësim të këtyre shkaqeve. Në nenin 480 të KPC-së parashikohet se nëse rekursi bëhet për shkaqe të ndryshme nga ato që i lejon ligji, ai nuk pranohet dhe mospranimi i tij vendoset nga kolegji i Gjykatës së Lartë në dhomën e këshillimit.

34. Nga parashikimet e normave të mësipërme procedurale, si dhe bazuar në veçoritë e gjykimit në Gjykatën e Lartë dhe praktikën e saj, Gjykata ka vlerësuar se në funksion të realizimit të vëzhgimit publik të administrimit të drejtësisë, si dhe të koherencës së vendimit gjyqësor, në mënyrë që përfundimi i procesit të vlerësimit të gjykatës të jetë i mbështetur, përmbajtja e vendimit përbën premisën për përmbushjen e standardit të arsyetimit të vendimit, i cili në këtë drejtim duhet të plotësojë dhe të përmbajë kriteret e përcaktuara nga dispozitat ligjore përkatëse dhe ato të zhvilluara nga jurisprudenca kushtetuese e konsoliduar (*shih vendimin nr. 3, datë 19.2.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

35. Në rastin konkret, vendimi nr. 00-2013-2018, datë 4.10.2013 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi) për mospranimin e rekursit përmban, në pjesën hyrëse të tij, palët ndërgjyqëse, objektin e padisë, disponimet e Gjykatës së Arbitrazhit Ndërkombëtar, Gjykatës së Apelit Tiranë, faktin se kundër vendimit të kësaj gjykate ka paraqitur rekurs kërkuarja dhe shkaqet që ka parashtruar në rekurs. Në vendim është pasqyruar vendimi i mëparshëm nr. 00-2012-869, datë 12.4.2012 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi), si dhe vendimi nr. 31, datë 10.7.2013 i Gjykatës Kushtetuese. Ndërsa në pjesën arsyetuese, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka arritur në përfundimin se rekursi i paraqitur nuk përmban shkaqe nga ato që parashikon neni 472 i KPC-së, duke vendosur në pjesën urdhëruese mospranimin e tij.

36. Për sa i përket rekursit në Gjykatën e Lartë, neni 480 i KPC-së parashikon se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, është organi që analizon dhe vlerëson nëse shkaqet e ngritura në rekurs janë në përputhje me kërkesat e ligjit, duke vlerësuar kështu nëse rekursi përmban shkaqe për t’u kaluar çështja për shqyrtim në seancë gjyqësore. Sikundër për pranimin,

ashtu edhe për mospranimin e rekursit, dhoma e këshillimit, nëpërmjet arsytimit të vendimeve të saj, luan rolin e një filtri paraelimator të kërkesave që i drejtohen Gjykatës së Lartë. Palët përpara kësaj trupe gjyqësore, në një numër të madh rastesh, *prima facie* i plotësojnë formalisht kriteret që kërkesa e tyre të shkojë në seancë gjyqësore, por kjo nuk mund t'ia deformojë funksionin vlerësues dhomës së këshillimit. Në rast se Kolegji në dhomën e këshillimit krijon bindjen se shkaqet e ngritura në rekurs objektivisht nuk gjejnë mbështetje në aktet e administruara në dosjen gjyqësore, atëherë është në kompetencën e tij të vendosë, në pajtim me kërkesat ligjore, mospranimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore. Megjithatë, nga pikëpamja kushtetuese, vetëm kur janë të pranishme pretendime që kanë të bëjnë me shkeljen e parimeve themelore të procesit civil, si dhe kur këto pretendime gjejnë pasqyrim në materialet e çështjes, vendimi i Kolegjit Civil për mospranimin e rekursit vë në dyshim të drejtën për një proces të rregullt ligjor (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 22, datë 6.6.2011*).

37. Për sa më sipër, Gjykata konstaton se vendimi i dhënë në dhomën e këshillimit nuk përbën cenim të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, pasi Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vepruar në përputhje me kërkesat e KPC-së. Arsytimi i këtij vendimi nuk paraqet ndonjë mangësi, e cila mund të ndikojë në cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor. Kjo formë arsyetimi është tashmë e konsoliduar në praktikën e Gjykatës së Lartë, përderisa shpreh në thelb shkaqet e mospranimit të rekursit nga ana e kolegjit civil në dhomë këshillimi (*shih vendimet nr. 6, datë 10.2.2014; nr. 17, datë 16.5.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

38. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuësës për cenimin e parimit të arsytimit të vendimit gjyqësor nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi) është i pabazuar.

C. Për pretendimin e cenimit të parimit të gjykimit brenda një afati të arsyeshëm

39. Kërkuësja, shoqëria "Iliria" s.r.l., ka pretenduar se është cenuar e drejta e gjykimit brenda një afati të arsyeshëm, pasi pas vendimit nr. 179, datë 26.12.2003 të Gjykatës së Apelit Tiranë, me të cilin u rivendos në afat e drejta e ankimit të Këshillit të Ministrave, kërkesa mori përgjigje pas 11 vjetësh me vendimin nr. 35, datë 31.2.2009 të Gjykatës së Apelit Tiranë.

40. Gjykata për pretendimin e cenimit të së drejtës të gjykimit të çështjes brenda një afati të arsyeshëm, në kuptim të nenit 42/2 të Kushtetutës, ka theksuar se ajo mbështetet në kriteret e përcaktuara nga GJEDNJ-ja, të reflektuara më pas edhe në praktikën e saj. Sipas këtyre kriterëve, arsyeja e kohëzgjatjes së procesit gjyqësor duhet të vlerësohet sipas rrethanave të veçanta të çështjes, duke pasur parasysh kompleksitetin e çështjes, sjelljen e kërkuësit, sjelljen e autoriteteve, si dhe rrezikun që sjell për kërkuësin kjo tejzgjatje e afateve të gjykimit (*shih vendimin nr. 12, datë 5.3.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

41. Gjykata konstaton se në çështjen konkrete jemi para një kërkesë për të njohur dhe dhënë fuqi vendimit datë 13.9.1993 të Gjykatës së Arbitrazhit Ndërkombëtar. Kjo kërkesë shqyrtohet bazuar në nenet 393-399 të KPC-së, si dhe në ligjin nr. 8688, datë 9.11.2000, "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në "Konventën për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja të arbitrazhit"". Gjykata e Apelit, si gjykatë kompetente, nuk shqyrton çështjen në themel, por kontrollon nëse vendimi i paraqitur për njohje nuk përmban dispozita që vijnë në kundërshtim me nenin 394 të KPC-së.

42. Nga rrethanat e çështjes në shqyrtim rezulton se objekti i vendimit të huaj ka qenë detyrimi i qeverisë shqiptare për t'i paguar shoqërisë "Iliria" s.r.l. shumën prej 48.239.000.000 (dyzet e tetë miliardë e dyqind e tridhjetë e nëntë milionë) liretash italiane. Me vendimin nr. 6, datë 2.4.1998, Gjykata e Apelit Tiranë i ka dhënë fuqi vendimit të datës 13.7.1993 të Gjykatës së Arbitrazhit Ndërkombëtar. Me vendimin nr. 73, datë 25.5.2000, Gjykata e Apelit ka vendosur plotësimin e dispozitivit për pagimin e interesave në masën 13% në vit deri në pagimin e plotë të shumës që përfaqëson detyrimin sipas vendimit të datës 13.9.1993. Me shkresën nr. prot.251/gj, datë

20.5.2002, Zyra e Përmbartimit Tiranë i është drejtuar Avokaturës së Shtetit pranë Këshillit të Ministrave, Drejtorisë së Buxhetit pranë Ministrisë së Financave, por nuk rezulton të jetë ekzekutuar qoftë edhe pjesërisht detyrimi.

43. Pas kërkesës së Këshillit të Ministrave në vitin 2003 për rivendosjen në afat të së drejtës së ankimit, çështja është kthyer nga Gjykata e Lartë 2 herë për rigjykim në Gjykatën e Apelit. Me vendimin nr. 35, datë 31.3.2009, Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur rrëzimin e kërkesës për njohjen e vendimit të huaj. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2012-869, datë 12.4.2012, ka vendosur mospranimin e rekursit. Kërkuesja i është drejtuar me kërkesë Gjykatës Kushtetuese, e cila me vendimin nr. 31, datë 10.7.2013 ka vendosur pranimin pjesërisht të kërkesës dhe kthimin për rigjykim në Gjykatën e Lartë. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi), me vendimin nr. 00-2013-2018, datë 4.10.2013, ka vendosur mospranimin e rekursit.

44. Gjykata çmon se në çështjen konkrete periudha që duhet të merret në konsideratë është prej vendimit nr. 35, datë 31.3.2009 të Gjykatës së Apelit deri në vendimin nr. 00-2012-869, datë 12.4.2012 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi).

45. Gjykata konstaton se kërkuesja pretendimin për cenimin e gjykimit të çështjes brenda një afati të arsyeshëm për këtë periudhë nuk e ka parashtruar në kërkesën drejtuar Gjykatës Kushtetuese, me të cilën ka pretenduar shfuqizimin e vendimit nr. 00-2012-869, datë 12.4.2012 të Kolegjit Civil i Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi).

46. Gjykata vlerëson se periudha nga vendimi nr. 31, datë 10.7.2013 i Gjykatës Kushtetuese deri në dhënien e vendimit nr. 00-2013-2018, datë 3.10.2013 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi), nuk konsiderohet periudhë e tejzgjatur kohore.

47. Për sa më sipër, në kushtet kur kërkesa drejtuar Gjykatës Kushtetuese mban datën 2.12.2014, Gjykata çmon se kërkuesja nuk legjitimohet për pretendimin e cenimit të gjykimit brenda një afati arsyeshëm, pasi nuk ka respektuar afatin 2-vjeçar të parashikuar nga neni 30, pika 2, i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

C. Për pretendimin e cenimin të parimit të gjykimit nga një gjykatë e paanshme

48. Kërkuesja ka pretenduar se dy prej gjyqtarëve A.N. dhe A.D. kanë marrë pjesë në një gjykim të mëparshëm për të njëjtën çështje, me të njëjtat palë, për të njëjtin objekt dhe shkak ligjor.

49. Nga materialet e çështjes rezulton se gjyqtarët A.N. dhe A.D. kanë qenë anëtarë të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, i cili me vendimin 00-2007-1233 (1067), datë 26.9.2007 ka vendosur prishjen e vendimit nr. 21, datë 14.2.2006 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në po atë gjykatë me tjetër trup gjykues. Gjyqtari A.D. rezulton se ka qenë anëtar i Kolegjit Civil (dhomë këshillimi) dhe relator i çështjes për të cilën, me vendimin nr. 00-2012-869, datë 12.4.2012, është vendosur mospranimi i rekursit dhe nuk rezulton të jetë anëtar i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi), i cili me vendimin nr. 00-2013-2018, datë 4.10.2013 ka vendosur po ashtu mospranimin e rekursit. Ndërsa gjyqtari A.N. rezulton të ketë qenë kryesues i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi) që ka dhënë vendimin nr. 00-2013-2018, datë 4.10.2013.

50. Për pretendimin për paanshmërinë e gjyqtarit A.D., Gjykata vlerëson se vendimi nr. 00-2012-869, datë 12.4.2012 i Kolegjit Civil, në të cilin ka marrë pjesë, nuk lidhet me këtë gjykim, pasi ai është prishur nga Gjykata Kushtetuese me vendimin nr. 31, datë 10.7.2013, duke e dërguar çështjen për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë. Kërkuesja në kërkesën e paraqitur më parë në këtë gjykatë nuk ka ngritur asnjë pretendim lidhur me cenimin e parimit të paanshmërisë nga gjyqtari A.D.

51. Në këto kushte, Gjykata konstaton se kërkuesja nuk legjitimohet *ratione temporis*, pasi nuk ka respektuar afatin 2-vjeçar të parashikuar nga neni 30, pika 2, i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë” për parashtrimin e pretendimit para kësaj gjykate.

52. Për pretendimin për paanshmërinë e gjyqtarit A.N., që ka qenë anëtar në dy kolegje, konkretisht në Kolegjin Civil të Gjykatës së Lartë, i cili me vendimin nr. 00-2007-1233 (1067), datë 26.9.2007 ka vendosur prishjen e vendimit nr. 21, datë 14.2.2006 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në po atë gjykatë me tjetër trup gjykues, si dhe në Kolegjin Civil (dhomë këshillimi), i cili me vendimin nr. 00-2013-2018, datë 4.10.2013 ka vendosur mospranimin e rekursit, Gjykata duke pasur parasysh karakteristikat e secilit vendim, vlerëson se pjesëmarrja e tij në këto dy gjykime nuk përbën cenim të parimit të paanshmërisë.

53. Vendimi i Gjykatës së Lartë për dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Apelit Tiranë nuk i ka dhënë zgjidhje përfundimtare çështjes. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës së Apelit dhe i ka kërkuar kësaj gjykate të ripërsërisë hetimin gjyqësor, me qëllim që palët e interesuara të paraqesin mjetet dhe provat që çmojnë në mbështetje të pretendimeve të tyre, përfshirë edhe ato që eventalisht gjykata mund t'i çmojë si të meta në kuptim të përmbajtjes së kërkesëpadisë, si dhe të dokumenteve e mjeteve të tjera që mbështesin kërkesën, aktet e përfaqësimit etj.

54. Kurse në lidhje me gjykimin e zhvilluar në Kolegjin Civil që ka vendosur mospranimin e rekursit për shqyrtim në seancë gjyqësore, Gjykata rithekson se ky Kolegj është organi që analizon dhe vlerëson në dhomë këshillimi nëse shkaqet e ngritura në rekurs janë në përputhje me kërkesat e ligjit, duke vlerësuar kështu nëse rekursi përmban shkaqe për t'u kaluar ose jo për shqyrtim në seancë gjyqësore. Sikundër për pranimin, ashtu edhe për mospranimin e rekursit, dhoma e këshillimit, nëpërmjet arsyetimit të vendimeve të saj, luan rolin e një filtri paraprak përzgjedhës të kërkesave që i drejtohen Gjykatës së Lartë. Veprimtaria seleksionuese e dhomës së këshillimit, për verifikimin nëse rekursi i plotëson ose jo kushtet për shqyrtim, nuk është një shkelje e së drejtës së palëve për t'iu drejtuar gjykatës apo e asaj për një gjykim publik, por një veprimtari e domosdoshme në funksion të aksesit në gjykatë vetëm të atyre çështjeve që i parashikon ligji, duke lënë jashtë përzgjedhjes kërkesat e paarsyeshme dhe haptazi të pambështetura në ligj (*shih vendimin nr. 45, datë 23.7.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

55. Për sa më sipër, Gjykata çmon se pretendimi i kërkuarës për cenimin e njërit prej elementeve të së drejtës për një proces të rregullt gjyqësor, që lidhet me besueshmërinë e gjykatës për të qenë objektivisht e paanshme, është haptazi e pabazuar.

56. Në përfundim, Gjykata vlerëson se kërkesa e shoqërisë "Iliria" s.r.l. për shfuqizimin e vendimeve nr. 35, datë 31.3.2009 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr. 00-2013-2018, datë 4.10.2013 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi) është e pabazuar dhe duhet rrëzuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës, si dhe të nenit 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", me shumicë votash,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Gani Dizdari, Altina Xhoxhaj, Fatmir Hoxha, Fatos Lulo, Besnik Imeraj
Anëtarë kundër : Bashkim Dedja (kryetar), Sokol Berberi, Vladimir Kristo, Vitore Tusha

MENDIM PARALEL

1. Në çështjen me kërkuarë shoqërinë "Iliria" s.r.l., ndonëse ndaj të njëjtin qëndrim me shumicën

për rrëzimin e kërkesës, nuk pajtohem me linjën e arsytimit të bërë prej saj.

2. Siç rezulton edhe nga rrethanat e kësaj çështjeje, kërkesja i është drejtuar edhe më parë kësaj Gjykate, e cila, me vendimin nr. 31, datë 10.7.2013, ka vendosur shfuqizimin e vendimit nr. 00-2012-869, datë 12.4.2012 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi) dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim. Në këtë vendim kam mbajtur qëndrim në pakicë, për arsye se shumica, edhe pse vlerësoi se pretendimet për cenimin e parimit të sigurisë juridike, për mohimin e së drejtës së ankimit (rekursit), të së drejtës së mbrojtjes dhe kontradiktoritetit, nuk ishin parashtruar nga kërkesja në rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë, pra nuk ishin shteruar mjetet e ankimit, e shfuqizoi atë vendim vetëm për shkak të mungesës së shkaqeve të rekursit. Pra, shumica u fokusua vetëm në paraqitjen formale të këtyre shkaqeve në pjesën hyrëse të vendimit, qëndrim ky që, siç kam theksuar në qëndrimet e mia të mbajtura në disa çështje të ngjashme, megjithëse shërben për të ndrequr një mangësi në formulimin e vendimeve të mospranimit nga kolegjet e Gjykatës së Lartë, është skematik dhe i padobishëm. Mbi të gjitha, ky qëndrim i jep vendimmarrjes së shumicës një karakter formal, pasi edhe pse, nga njëra anë, kënaq pretendimin për shfuqizimin e vendimit të Gjykatës së Lartë, nga ana tjetër, dhe që është më e rëndësishme, nuk u jep përgjigje pretendimeve me natyrë kushtetuese të kërkesit.

3. Gjykata duhet të investohet nëse konstaton shkelje të parimeve të procesit të rregullt ligjor dhe nëse këto shkelje nuk janë konstatuar dhe riparuar nga Gjykata e Lartë. Në rast se Gjykata nuk arrin në një përfundim të tillë, pra që procesi i zhvilluar në të tria shkallët e gjykimit është i cënueshëm, nga pikëpamja kushtetuese, ajo nuk mundet të shfuqizojë një vendim të Gjykatës së Lartë vetëm me arsytimin se ai nuk përmban shkaqet e paraqitura në rekurs, por kjo, në vlerësimin tim, nuk e pengon Gjykatën që edhe në rastet e mospranimit të kërkesës, t'i tërheqë vërejtje Gjykatës së Lartë në mënyrë që të riparojë këto të meta në të ardhmen.

4. Në kërkesën e parë të paraqitur para Gjykatës, kërkesja ka ngritur pretendime që lidhen me cenimin e së drejtës së aksesit në gjykatë, të së drejtës së mbrojtjes dhe kontradiktoritetit, pasi procesi është zhvilluar në mungesë të saj, apo të parimit të veprimit të ligjit në kohë dhe hapësirë, si element i parimit të sigurisë juridike. Në lidhje me këto pretendime Gjykata nuk e ka legjitimuar kërkesën, pasi ato nuk ishin paraqitur më parë në rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë, pra kërkesja nuk ka shteruar mjetet ligjore për mbrojtjen e tyre (vendimi nr. 31, datë 10.7.2013). Duke mos i marrë fare në shqyrtim këto pretendime, Gjykata nuk arriti të vlerësojë nëse procesi gjyqësor ka shfaqur probleme që e bënin atë të cënueshëm nga pikëpamja kushtetuese.

5. Pas rishqyrtimit të çështjes në Gjykatën e Lartë, Kolegji Civil i asaj gjykate, me vendimin nr. 00-2013-2018, datë 4.10.2013, ka vendosur sërish mospranimin e rekursit. Për pasojë, kërkesja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese për kundërshtimin e këtij vendimi, duke parashtruar në kërkesë si pretendimet e paraqitura në kërkesën e mëparshme, konkretisht cenimin e parimit të sigurisë juridike, të së drejtës së ankimit (rekursit), të së drejtës së mbrojtjes dhe kontradiktoritetit, ashtu edhe disa pretendime të tjera, që lidhen me parimet e zbatimit të ligjit në kohë, të arsytimit të vendimit të Kolegjit Civil, të gjykimit brenda një afati të arsyeshëm dhe të paanshmërisë në gjykim.

6. Siç kam theksuar edhe më sipër, në shqyrtimin e kërkesave individuale Gjykata duhet të investohet nëse shkeljet e konstatuara të së drejtës për një proces të rregullt ligjor nuk janë konstatuar dhe riparuar nga Gjykata e Lartë. Të gjitha pretendimet e ngritura nga kërkesja nuk janë ngritur më parë para kësaj Gjykate, për pasojë ato nuk mund të ngrihen më në këtë kërkesë, për shkak të mosshterimit të mjeteve ligjore të ankimit, në kuptim të nenit 131/f të Kushtetutës. Gjykata mund të marrë në shqyrtim vetëm pretendimet që lidhen me procesin e zhvilluar në Gjykatën e Lartë pas kthimit të çështjes për rigjykim. Në këtë kuptim, shumica nuk duhej të ndalej në analizimin e pretendimeve të tjera të kërkeses, që lidhen me procesin e zhvilluar në Gjykatën e Apelit, por vetëm në vlerësimin e plotësimit të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor, pra të plotësimit të kërkesës për paraqitjen e shkaqeve të rekursit në vendim.

7. Për sa i takon vendimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, pas kthimit të çështjes për rishqyrtim, rezulton se ai i ka plotësuar të metat formale të evidentuara në vendimin e sipërcituar të Gjykatës dhe ka arsyetuar qëndrimin e tij për mospranimin e rekursit.

8. Këto janë argumentet ku mbështes qëndrimin tim paralel për rrëzimin e kësaj kërkesë.

Anëtare: Altina Xhoxhaj

MENDIM PAKICE

1. Jam i mendimit se kërkesa e shoqërisë “Iliria” s.r.l., lidhur me pretendimin për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi), duhej pranuar për arsytet e mëposhtme.

2. Nga rrethanat e çështjes, sikurse arsyetohet edhe shumica (*shih paragrafin nr. 19 të vendimit*), rezulton se kërkesja i është drejtuar edhe më parë kësaj Gjykate për cenim të së drejtës për një proces të rregullt ligjor. Gjykata, me vendimin nr. 31, datë 10.7.2013, ka vendosur pranimin pjesërisht të kërkesës, duke shfuqizuar vendimin nr. 00-2012-869, datë 12.4.2012 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi) dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën e Lartë. Gjykata në këtë vendim arsyetonte se “*mungesa e paraqitjes së shkaqeve të parashtruara në rekurs, në vendimin e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi), përbën një të metë të pakapërcyeshme të përmbajtjes së vendimit dhe të arsyetimit të gjykatës. [...] Gjykata çmon, gjithashtu, se prima facie, mosparaqitja në vendimin e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi) e shkaqeve të parashtruara nga kërkuuesi në rekurs, krijon dyshime edhe për cenimin e së drejtës së ankimit efektiv, si dhe të së drejtës për t’u dëgjuar, të pretenduara nga kërkuuesja. Në këtë këndvështrim, pasqyrimi i shkaqeve të rekursit në pjesën hyrëse të vendimit të Kolegjit të Gjykatës së Lartë përbën një element të domosdoshëm dhe të rëndësishëm të tij, i cili nuk ka thjesht karakter formal në përmbajtjen e vendimit gjyqësor*” (shih paragrafët 38-39 të vendimit nr. 31, datë 10.7.2013 të Gjykatës Kushtetuese).

3. Pavarësisht këtij vlerësimi të Gjykatës, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, përsëri në dhomë këshillimi, me vendimin nr. 00-2013-2018, datë 4.10.2013, ka vendosur mospranimin e rekursit.

4. Në këto rrethana, kërkuuesja i është drejtuar rishtazi kësaj Gjykate duke pretenduar se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi), me vendimin e lartpërmendur, ka cenuar parimin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, pasi nuk ka arsyetuar shkaqet e mospranimit të rekursit (*shih paragrafin nr. 31 të vendimit*).

5. Shumica, pasi ka konstatuar se vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë përmbush kriteret e caktuara nga neni 310 i KPC-së lidhur me përmbajtjen e vendimit (*shih paragrafin nr. 35 të vendimit*), mbështetur në nenin 480 të KPC-së, ka arritur në përfundimin se vendimi i kundërshtuar nuk përbën cenim të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, pasi Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vepruar në përputhje me kërkesat e Kodit të Procedurës Civile. Kjo formë arsyetimi, sipas shumicës, është tashmë e konsoliduar në praktikën e Gjykatës së Lartë, përderisa shpreh në thelb shkaqet e mospranimit të rekursit nga ana e kolegjit civil në dhomë këshillimi (*shih paragrafët 37 dhe 38 të vendimit*).

6. Argumentet e mësipërme të shumicës për rrëzimin e kërkesës në këndvështrimin tim janë të pabazuara. Për më tepër mendoj se ky vendim i shumicës e bën vendimmarrijen e kësaj Gjykate formale dhe aspak efektive. Gjithashtu, ky vendim bie ndesh me Kushtetutën dhe cenon standardin e vendosur nga kjo Gjykatë mbi forcën detyruese të vendimeve të saj.

7. E drejta për një proces të rregullt ligjor, që i garantohet individit nga neni 42 dhe neni 142/1 i Kushtetutës, si dhe neni 6 i KEDNJ-së, përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar. Funkcioni i një vendimi të arsyetuar është t’u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Përveç kësaj, duke dhënë një vendim të arsyetuar, mund të

realizohet vëzhgimi publik i administrimit të drejtësisë (*shih vendimet nr. 8, datë 28.2.2012, nr. 8, datë 16.3.2011, nr. 25, datë 10.6.2011; nr. 38, datë 30.12.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

8. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar domosdoshmërinë e arsytimit të vendimeve gjyqësore, penale apo civile, si një garanci për procesin ligjor. Vendimi duhet të mbështetet vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor dhe duhet të përmbajë bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Vendimi mund të kontrollohet nga një gjykatë më e lartë sipas procedurave përkatëse dhe që kjo të jetë e mundur, duhet bërë arsyetimi i vendimit, në të cilin gjyqtari tregon me qartësi faktet dhe ligjin e zbatueshëm që e kanë çuar në bërjen e një zgjedhjeje ndërmjet disa mundësive. Vendimet gjyqësore që japin gjykatat e të gjitha niveleve në përfundim të gjykimit, përbëjnë aktin procedural kryesor të të gjithë procesit gjyqësor. Ato përmbledhin dhe finalizojnë përfundimisht qëndrimet që mban gjykata lidhur me çështjen në gjykim (*shih vendimet nr. 8, datë 16.3.2011; nr. 23, datë 4.11.2008; nr. 7, datë 9.3.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

9. Zbatimi i këtij parimi është vlerësuar nga Gjykata rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e vendimeve të tyre. Ajo ka verifikuar nëse vendimi i kundërshtuar është logjik, ka kundërthënë, përmban referencat në ligjin e zbatueshëm dhe nëse respekton të gjitha elementet e sipërpërmendura. Gjykata ka theksuar, gjithashtu, se detyrimi për të respektuar këtë standard ndryshon në varësi të rrethanave të çështjes konkrete dhe natyrës së vendimit, dhe se masa e arsytimit varet nga natyra e vendimit në fjalë (*shih vendimin nr. 25, datë 10.6.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Në rastin konkret, sikurse u përmend më lart, çështja është shqyrtuar më parë nga kjo Gjykatë. Në këtë drejtim, Gjykata është shprehur se zbatimi i detyrueshëm i vendimeve të saj është i garantuar nga Kushtetuta, e cila në nenin 132 dhe nenin 145 të saj sanksionon shprehimisht këtë koncept kushtetues. Vendimet e Gjykatës kanë fuqi detyruese të përgjithshme dhe janë përfundimtare. Ato përbëjnë jurisprudencë kushtetuese dhe, për rrjedhojë, kanë efektet e *forcës së ligjit*. Ky efekt detyrues ka të bëjë si me pjesën urdhëruese, ashtu edhe me pjesën arsyetuese të vendimit. Në respekt të doktrinës dhe të jurisprudencës kushtetuese, Gjykata ka theksuar se efekti detyrues që pasqyrohet mbi argumentet thelbësore të vendimit të saj përbën edhe një *ratio decidendi*, eliminimi i të cilave do ta bënte vendimin, në tërësinë e tij, të pakuptimtë. Nga kjo pikëpamje, Gjykata ka theksuar se nga standardi i detyrimit të zbatimit të vendimarrjes kushtetuese nuk mund të bëjë përjashtim as vet Gjykata Kushtetuese (*shih vendimet nr. 5, datë 7.2.2001; nr. 14, datë 3.6.2009; nr. 21, datë 29.4.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Ndikimi i padiskutueshëm i vendimeve të Gjykatës është i tillë që iu imponon të gjitha organeve shtetërore, duke mos përjashtuar as gjykatat, fuqinë detyruese të arsytimit të vendimit të saj. Arsyetimi që përdor Gjykata në vendimet e saj ka forcën e ligjit, çka buron nga autoriteti i këtij organi për të thënë fjalën e fundit në çështjet për të cilat të tjerët tashmë janë shprehur. Çdo qëndrim i kundërt krijon një precedent të rrezikshëm në marrëdhëniet institucionale (*shih vendimet nr. 5, datë 7.2.2001; nr. 20, datë 1.6.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Pavarësisht se në vendimin nr. 31, datë 10.7.2013 jam shprehur me mendim paralel, duke i qëndruar konsekuent jurisprudencës së Gjykatës, kjo e fundit në vendimarrjen e mëparshme të saj ka vlerësuar se kërkueses i janë cenuar të drejtat e veta kushtetuese. Konkretisht, Gjykata ka konstatuar jo vetëm mungesën e paraqitjes në vendimin e Gjykatës së Lartë së shkaqeve të parashtruara në rekurs, por ka vlerësuar edhe se ky fakt *krijon dyshime edhe për cenimin e së drejtës së ankimit efektiv, si dhe të së drejtës për t'u dëgjuar, të pretenduara nga kërkuesja*. Në këto kushte, mendoj se këto fakte nuk mund të anashkalohen, por përkundrazi duhet t'i nënshtrohen një procesi vlerësimi nga Gjykata e Lartë, dhe si të tilla nuk mund të garantohen në dhomë këshillimi. Gjykata e Lartë ka

për detyrë të sigurojë zbatimin korrekt të ligjit procedural dhe material nga të gjitha gjykatat, në përputhje me Kushtetutën dhe vendimet e kësaj Gjykate. Një zgjidhje e ndryshme nga sa ka vendosur Gjykata në vendimin nr. 31, datë 10.7.2013 do të ishte antikushtetuese, pasi nuk do të respektohej një akt parësor i nxjerrë pikërisht nga një burim parësor siç është Gjykata Kushtetuese (*shih vendimin nr. 20, datë 1.6.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Nisur nga rrethana se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, pas rigjyimit të çështjes, edhe pse formalisht i ka plotësuar kriteret e caktuara nga neni 310 i KPC-së lidhur me përmbajtjen e vendimit, jam i mendimit se ky vendim nuk i ka përmbushur në mënyrë të plotë detyrimet e përcaktuara në vendimin nr. 31, datë 10.7.2013 të Gjykatës, për sa kohë pretendimet e kërkuases në thelb nuk kanë marrë ende përgjigje të shprehur, dhe si të tilla krijojnë përsëri dyshime të arsyeshme lidhur me cenimin e së drejtës së ankimit efektiv, si dhe të së drejtës për t'u dëgjuar.

14. Në këto kushte, duke mbajtur në konsideratë edhe efektin detyrues të vendimeve të saj, të shtjelluar më lart, vlerësoj se vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë duhej të shfuqizohej.

15. Si përfundim, mendoj se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë nuk ka respektuar standardin kushtetues të arsyetimit të vendimeve gjyqësore, për rrjedhojë pretendimi i kërkuases në këtë aspekt është i bazuar dhe duhej pranuar.

Anëtar: Vladimir Kristo

MENDIM PAKICE

1. Për arsye se nuk ndajmë të njëjtin qëndrim me shumicën lidhur me përfundimin e arritur në çështjen me kërkuese shoqërinë "Iliria" s.r.l., si dhe me argumentet mbi të cilat mbështetet ky qëndrim, e çmojmë të rëndësishme të shprehemi me mendim pakice.

2. Nëpërmjet arsyetimit të saj shumica ka konstatuar se "kërkuësja pretendimet për cenimin e parimit të sigurisë juridike, parimit të mohimit të së drejtës së ankimit (rekursit), të së drejtës së mbrojtjes dhe kontradiktoritetit i ka paraqitur edhe më parë në kërkesën e saj drejtuar Gjykatës Kushtetuese. Gjykata Kushtetuese i ka shqyrtuar pretendimet dhe me vendimin nr. 31, datë 10.7.2013 ka vendosur pranimin pjesërisht të kërkesës, duke shfuqizuar vendimin nr. 00-2012-869, datë 12.4.2012 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi) dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën e Lartë". Për rrjedhojë, shumica ka arritur në përfundimin se "Gjykata Kushtetuese, me vendimin nr. 31, datë 10.7.2013, i ka dhënë përgjigje kërkuases, duke arsyetuar se lidhur me këto pretendime kërkuësja nuk ka nuk shteruar mjetet juridike, pasi nuk i ka parashtruar në rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë" (*prg. 26-27 të vendimit*).

3. Nuk pajtohem me këtë përfundim të shumicës, për sa i përket pretendimit të cenimit të së drejtës së ankimit, për arsyet në vijim.

4. Neni 43 i Kushtetutës parashikon se "*kushdo ka të drejtë të ankohet kundër një vendimi gjyqësor në një gjykatë më të lartë, përveçse kur në Kushtetutë parashikohet ndryshe*". Gjykata e ka vlerësuar të drejtën e ankimit ndaj një vendimi gjyqësor të lidhur me të drejtën e aksesit, si pjesë të pandara dhe garanci të procesit të rregullt gjyqësor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës. Sipas jurisprudencës së konsoliduar të kësaj Gjykate, e drejta e ankimit duhet kuptuar si mundësi e çdo individi për të pasur mjete të caktuara procedurale për të kundërshtuar vendimin e dhënë nga një gjykatë më e ulët në një gjykatë më të lartë, duke i garantuar individit të drejtën për t'u përballur me drejtësinë në të gjitha nivelet e saj (*shih vendimet nr. 6, datë 26.2.2013; nr. 5, datë 2.3.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

5. Gjykata ka pohuar se e drejta e ankimit, e sanksionuar në nenin 43 të Kushtetutës, është një e drejtë procedurale, që shërben për të mbrojtur një të drejtë substanciale. Kjo e drejtë bazohet në parimin se "*...nuk mund të ekzistojë një e drejtë pa të drejtën e ankimit*". Në këtë kuptim, në funksion të ushtrimit efektiv të së drejtës së ankimit, ka rëndësi të realizohet si aspekti formal/procedural, ashtu edhe ai substancial. Kërkesat procedurale të ankimit janë para së gjithash në funksion të aksesit që

duhet të kenë individët për të ushtruar efektivisht ankimin ndaj vendimit gjyqësor. Çdo instancë ankimuese që njeh sistemi i normave procedurale është pjesë e së drejtës së individit për të pasur akses në gjykatë. Aksesit në gjykatë është një kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera. Mohimi i së drejtës për t'iu drejtuar gjykatës dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare prej saj për pretendimet e ngritura, përbën cenim të së drejtës themelore për një proces të rregullt ligjor (*shih vendimet nr. 6, datë 26.2.2013; nr. 14, datë 26.3.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

6. Gjykata ka vlerësuar edhe më parë se “administrimi i mirë i drejtësisë fillon me garancinë që një individ të ketë akses në gjykatë për t'i siguruar atij të gjitha aspektet e një forme gjyqësore të shqyrtimit të çështjes. E drejta e aksesit në një organ gjyqësor duhet të jetë një e drejtë që lidhet me themelin dhe jo një e drejtë e pastër formale. Kjo e drejtë e individit nuk përfshin vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesit në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal (*shih vendimet nr. 8, datë 26.2.2015; nr. 53, datë 20.7.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

7. Për shkak të natyrës së çështjes së themelit, që ka të bëjë me njohjen e një vendimi të dhënë nga gjykata e arbitrazhit, gjykimi konkret është zhvilluar në dy shkallë, ku gjykata e apelit konsiderohet si shkallë e parë, ndërsa Gjykata e Lartë si instancë ankimuese. Këto lloj gjykimesh rregullohen nga titulli III, kreu IX i Kodit të Procedurës Civile (KPC). Nga rrethanat faktike të çështjes rezulton se kërkuësja ka ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë, e cila, në dhomë këshillimi, me vendimin nr. 00-2012-869, datë 12.4.2012, ka vendosur mospranimin e rekursit. Ky vendim i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë është shfuqizuar nga Gjykata, me vendimin nr. 31, datë 10.7.2013, për arsye të mungesës së paraqitjes së shkaqeve të rekursit në vendim. Çështja është dërguar për rigjykim në Gjykatën e Lartë, e cila, në dhomë këshillimi, me vendimin nr. 00-2013-2018, datë 4.10.2013, ka vendosur përsëri mospranimin e rekursit. Pra, në të dyja rastet kur ka shqyrtuar rekursin Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e tij në dhomë këshillimi. Duke pasur parasysh veçoritë e çështjes konkrete, e cila është gjykuar në dy shkallë, ku Gjykata e Lartë ka qenë e vetmja shkallë apeli, vlerësojmë se kërkuësja nuk e ka realizuar të drejtën e ankimit efektiv. Megjithatë formalisht kërkuësja ka pasur akses dhe është ankuar ndaj vendimit të gjykatës së apelit, efektivisht ajo nuk ka mundur të marrë përgjigje përfundimtare për pretendimet e ngritura nga një gjykatë më e lartë. Është detyrë e Gjykatës së Lartë të bëjë të mundur realizimin efektiv të së drejtës së aksesit, pa lënë shkas për ekuivoke në lidhje me marrjen në shqyrtim dhe vlerësimin e pretendimeve të kërkuësit nga ana e saj (*shih vendimin nr. 28, datë 15.5.2014 të Gjykatës Kushtetuese*). Në kontekstin konkret, Gjykata e Lartë, në rolin e një gjykate apeli, duhej të merrte në shqyrtim pretendimet, t'i vlerësonte ato dhe t'u jepte përgjigje përfundimtare të arsyetuar. Kërkuësja në rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë ka ngritur pretendime për cenimin e parimit të sigurisë juridike dhe zbatimit të ligjit në kohë, të së drejtës së kontradiktoritetit dhe barazisë së armëve, si dhe mohimit të së drejtës së ankimit. Gjykata e Lartë duhej të arsyetonte mbi këto pretendime, pasi vetëm në këtë mënyrë kërkuësja do t'i garantohej aksesit dhe ankimi efektiv në një gjykatë më të lartë. Në vendimin nr. 31, datë 10.7.2013 është evidentuar nga Gjykata se mungesa e paraqitjes së shkaqeve të rekursit krijonte dyshime edhe mbi cenimin e së drejtës së aksesit dhe të ankimit efektiv. Në vlerësimin tonë edhe pas rikthimit dhe rigjykimit të çështjes në Gjykatën e Lartë dyshimet për cenimin e së drejtës së aksesit dhe ankimit efektiv nuk janë korrigjuar.

8. Për sa më sipër, bazuar në veçoritë e çështjes konkrete, vlerësojmë se Gjykata e Lartë nuk ka bërë të mundur realizimin efektiv të së drejtës së aksesit dhe të së drejtës së ankimit nga ana e kërkuësjes, ndaj për këtë arsye shumica duhej ta shfuqizonte atë.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Sokol Berberi